REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4231/1 Prot

Rrëshen, më 01 . 10 . 2026

V E N D I M

Nr. 72 datë 25. 09. 2026
PËR
"PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE",
BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 87/2025, "Per buxhetin e vitit 2026", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", VKB nr. 98, datë 10.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", *Kërkesën nr. 2696/1 prot, datë 24.08.2026 së bashku me projektin; "Matura në Faqet e Dijes", nga Aleanca e Grave Këshilltare Bashkiake Mirditë,* së bashku me projektin e Kryetarit Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin në mbledhjen e datës 23.09.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit,* për t'a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, *në shumën **113 390** (njëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë*, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;

- T'i akordojë ndihmë financiare, për Projektin: "*Matura në Faqet e Dijes*", blerjen e librave jashtëshkollor, në kuadër të mbështetjes së nxënësve maturantë dhe përmirësimt të fondit të bibliotekës "*Gjon Gazulli*", qyteti Rrëshen

   a. **Paksim:** Fond rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...609) në vlerën;.**113 390** lekë

   b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;..... **113 390** lekë

2. Pagesa të kryehet, *në bazë të dokumenteve dhe faturës fiskale që vërtetojnë shpenzimet*, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen ose në nr. e llogarinë bankare të subjektit

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Financës dhe Buxhetit)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

S E K R E T A R

Gaspër TOPOLLAJ

K R Y E T A R

Aleksandër PICAKU

ADRESA: SHESHI "ATË TOCI" RRËSHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr 4231 prot Rreshen me 18/09/2026

P/V E N D I M

Nr. 91 date. 18.9. .2026

"PËR PERDORIM FOND REZERVE "

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 87/2025, "Per buxhetin e vitit 2026" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", ,ne VKB nr.98 datë 10.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", në kerkesen per financim, nr.2696/1prot, datë.24.08.2026, e Aleances se keshilltareve bashkiake, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise

V E N D O S I:

I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 113 390 lekë, për blerje libra jashte shkollore, ne mbeshtetje te maturanteve si me poshte

a-Paksim:fondi rezervë (AI133 00 2133001 01 V491AAA..609) për shumën ***113 390 lekë***

b-Shtohet (AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën ***113 390 lekë***

.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen .

II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori e finances dhe buxhetit.

III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr.Finance/buxhet:: V.Gjoka

Pergj sekt juridik: L..Gjergji

KRYETARI
Albert MËLYSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.

G.Top Nr. 2696/1 Prot
Dt. 24.08.2026

Rrëshen më, **24. 08. 2026**

ALEANCA E KËSHILLTAREVE BASHKIAKE MIRDITË

Lënda: Kërkesë për financim

Titulli i Projekt: "Matura në faqet e dijes"

Drejtuar: **KRYETARIT TË BASHKISË**
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Agjensia e Arsimit dhe Sportit

Në mbështetje të Kërkesës për pasurimin e bibliotekës së shkollës Gjimnazi Rrëshen, me libra jashtëshkollor (*me nr. **162** prot, datë **12.06.2026** & protokoll hyrës në Bashki nr. **2696** prot, datë **15.06.2026***) drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, në kuadër të mbështetjes së nxënësve maturantë por dhe përmirësimit të fondit të bibliotekës publike "Gjon Gazulli" Rrëshen, është evidentuar nevoja për përmirësimin e bibliotekës me veprat letrare të përfshira në programet e leximit për maturantët.
Në vijimsi të projekteve që **Aleanca e Këshilltareve Bashkiake Mirditë** ka realizuar, po ju paraqesim, "**Matura në faqet e dijes**" projekt që ka në fokus parësor maturantët por dhe dashamirësit e librit në përgjithësi, në territorin e Bashkisë Mirditë.
Për këtë qëllim, është përgatitur lista prej 22 titujsh, nga stafi pedagogjik përgjegjës pranë Gjimnazit Rrëshen. Veprat letrare do të merren në dorëzin nga bibloteka publike e qytetit në mënyrë të tillë që të mund të kënë akses të gjithë gjimanizistët në territorin e Bashkisë Mirditë.
Veprat letrare janë kërkuar në 5 kopje secila.
Janë kontaktuar me mail:

1. Ardion
2. Bukinist.Al
3. Botimet Toena
4. Babel
5. Botime Dudaj

Prej të cilava oferta më e plotë ishte ajo e shtëpisë botuese " Babel" me vlerë **113 390 lekë** (bashkëngjitur oferta).
Ky projekt kontribuon në zbatimin e politikave bashkiake në fushën e arsimit, kulturës dhe rinisë, të cilat synojnë mbështetjen e nxënësve, nxitjen e leximit dhe zhvillimin e aksesit të barabartë në burime arsimore e kulturore.
Bashkëlidhur kërkesa e shkollës Gjimnazi Rrëshen, projekti dhe oferta e Shtëpisë Botuese "Babel"

Faleminderit shumë për bashkëpunimin tuaj!

ALEANCA E GRAVE KËSHILLTARE MIRDITË
KRYETAR
Marjana Molla

Nr. 2696 Prot
Dt. 15.06.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITARIA
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR MIRDITË
GJIMNAZI RRËSHEN

Nr. 162 Prot. Rrëshen , më 12.06. 2026

Lënda: Kërkesë për pasurimin e bibliotekës së shkollës me libra jashtëshkollor.

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë Mirditë z Albert Melyshi.
Këshillit Bashkiak Mirditë.

Për dijeni: ZVAP Mirditë.

Autori	Titulli	Nr
Eskili	Prometeo i mbërthyer	4
Homeri	Iliada	4
Euripidi	Medea	4
Dante Aligeri	Komedia Hyjnore	4
Servantesi	Don Kishoti	4
Shekspiri	Hamleti	4
Naim Frashëri	Lulet e veres	4
Jorenin de Rada	Këngët e Milosaos	4
Gëte	Fausti	4
Viktor Hygo	Katedralja e Paraisit	4
Bajroni	Shtegtimet e Çarld Haroldit	4
Flober	Zonja Bovari	4
Dostojevski	Vëllezërit Karamozov	4

Balzak	Xha Gorio	4
Sharl Bolder	Lulet e së keqes	4
Kamy	I Huaji	4
Kafka	Procesi	4
Lasgush Poradeci	Vallja e Yjeve,Ylli i zemrës	4
Migjeni	Novelat e qytetit të veriut, Vargjet e lira.	4
Gjergj Fishta	Lahuta e Malcisë.	4
Ismail Kadare	Nënpunësi i Pallatit të Ëndërrave	4
Dritëro Agolli	Shkëlqimi dhe rëia e shokut Zulo.	4

DREJTORI

Donika Lleshaj

EMRI I PROJEKTIT

Përgatiti:

Matura në Faqet e Dijes	Rigerta Loku Tushaj

SINTEZA E PROJEKTIT

- Ky projekt synon t'u vijë në ndihmë maturantëve të Mirditës, duke siguruar veprat letrare të detyrueshme për provimet e Maturës Shtetërore, të cilat aktualisht nuk gjenden në fondet e bibliotekave publike apo shkollore të bashkisë.

- Projekti parashikon blerjen e nga pesë kopjeve për secilën vepër letrare dhe depozitimin e tyre në Bibliotekën Publike "Gjon Gazulli", e cila do të shërbejë si qendër referimi për të gjitha gjimnazet e Mirditës. Në këtë mënyrë, çdo maturant do të ketë mundësi të huazojë literaturën e nevojshme për përgatitjen e provimeve, pa u kufizuar nga mungesa e librave apo nga pamundësitë ekonomike.

- Përmes këtij projekti synohet të garantohet akses i barabartë në literaturën e detyrueshme, të nxitet kultura e leximit dhe të mbështetet përgatitja cilësore e maturantëve për provimet e Maturës Shtetërore, të cilat përbëjnë një hap vendimtar drejt studimeve universitare dhe zhvillimit të tyre akademik e personal.
- Veprat letrare nuk janë vetëm mjete për përgatitjen e provimeve të Maturës, por edhe një investim në formimin kulturor, kritik dhe qytetar të të rinjve. Leximi i tyre zhvillon mendimin analitik, pasuron kulturën e përgjithshme dhe i përgatit maturantët për sfidat akademike që i presin në universitet.

- Duke e përqendruar këtë fond në Bibliotekën Publike "Gjon Gazulli", projekti krijon një burim të qëndrueshëm dhe afatgjatë në shërbim të të gjithë maturantëve të Mirditës, duke promovuar njëkohësisht kulturën e leximit, barazinë në arsim dhe mbështetjen për suksesin e brezave të rinj.

OBJEKTIVAT

1. Sigurimi i aksesit të barabartë në literaturën e Maturës Shtetërore

Të pajiset Biblioteka Publike "Gjon Gazulli" me veprat letrare të nevojshme për maturantët, duke u mundësuar të gjithë nxënësve të gjimnazeve të Mirditës përdorimin e tyre për përgatitjen e provimeve.

2. Mbështetja e përgatitjes akademike dhe suksesit të maturantëve

Të krijohet një mundësi konkrete për maturantët që të lexojnë dhe studiojnë veprat letrare të programit, duke përmirësuar përgatitjen e tyre për provimet e Maturës dhe për sfidat e studimeve universitare.

3. Zhvillimi i kulturës së leximit dhe pasurimi i fondit bibliotekar lokal

	Të krijohet një fond i qëndrueshëm letrar në shërbim të të rinjve të Mirditës, duke nxitur interesin për letërsinë, dijen dhe formimin kulturor të brezave të ardhshëm.
FUSHA E VEPRIMIT	▪ Arsim, kulturë dhe bibliotekë publike – projekti synon mbështetjen e maturantëve të gjimnazeve të Bashkisë Mirditë përmes sigurimit të aksesit në veprat letrare të programit të Maturës Shtetërore, duke pasuruar fondin e Bibliotekës Publike "Gjon Gazulli" dhe promovuar leximin si një mjet për zhvillimin arsimor dhe kulturor.
REZULTATET	1. Krijimi i një fondi të ri me veprat letrare të Maturës Shtetërore në Bibliotekën Publike "Gjon Gazulli", me nga pesë kopje për secilën vepër të programit. 2. Rritja e aksesit të maturantëve të të gjitha gjimnazeve të Bashkisë Mirditë në literaturën e detyrueshme, duke u mundësuar huazimin e librave gjatë periudhës së përgatitjes për provimet. 3. Përmirësimi i përgatitjes së maturantëve për provimet e Maturës Shtetërore dhe nxitja e kulturës së leximit, përmes një burimi të qëndrueshëm që do të mbetet në dispozicion të brezave të ardhshëm.
MATRICAT E ZBATIMIT	◦ Përfitues në këtë projekt janë maturantët e gjimnazeve ne territorin e Bashkisë Mirditë. ◦ Mësuesit e gjuhës dhe letërsisë pranë gjimnazeve të Bashkisë Mirditë. ◦ Brezat e ardhshëm të maturantëve. ◦ Komuniteti lokal përmes pasurimit të Biblotekës Publike "Gjon Gazulli".
KRONOLOGJIA	**KOHËZGJATJA** 30 ditë (15 Shtator - 15 Tetor 2026)
	FAZAT E PROJEKTIT	**THELBËSORE**
	▪ **Faza 1**: Marrja në dorëzim e kërkesës dhe listës së veprave letrare drejtuar Bashkisë Mirditë nga "Gjimnazi Rrëshen". ▪ **Faza 2**: Kontakti dhe marrja e ofertve nga bibloteka dhe shtepi botimi të ndryshme. ▪ **Faza 3**: Blerja e veprave letrare sipas listës së përcaktuar. ▪ **Faza 4**: Dorëzimi i veprave letrare pranë Biblotekës Publike "Gjon Gazulli. ▪ **Faza 5**: Monitorim dhe raportim për zbatimin dhe ndikimin e projektit.	Angazhimi dhe bashkëpunimi ndërmjet: ◦ Aleancës së Këshilltareve Bashkiake Mirditë ◦ Gjimnazi Rrëshen ◦ Agjensia e Arsimit dhe sportit, Bashkia Mirditë

SKUADRA	**ROLI**	**DETYRA**
	Marjana Molla	Koordinatore e projektit
	Teuta Bardhoku	Bashkëpunëtore
	Agjensia e Arsimit dhe Sportit	Lehtësuese e projektit
BUXHETI	TOTALI	**113 390 lekë**

Titulli / Shteia Botuese	Cmimi	Sasia	Totali
Homeri - Iliada (Onufri)	1,500	5	7,500
Eskili - Prometeu i mbërthyer (Dudaj) Eskili në prozë (zëvendësim)	1,000	5	5,000
Euripidi - Medea (Albas)	700	5	3,500
Dante Aligeri - Komedia Hyjnore (Onufri)	3,000	5	15,000
Servantesi - Don Kishoti (Onufri), Vëll. 1	1,200	5	6,000
Servantesi - Don Kishoti (Onufri), Vëll. 2	1,500	5	7,500
Shekspiri - Hamleti (Onufri)	800	5	4,000
Naim Frashëri - Lulet e Verës (Uegen)	500	5	2,500
Jeronim de Rada - Këngët e Milosaos (Albas)	700	5	3,500
Gete - Fausti (Argeta)	800	5	4,000
Hygo - Katedralja e Parisit (Argeta)	1,200	5	6,000
Bajroni - Shtegtimet e Çarld Haroldit (Argeta)	800	5	4,000
Flober - Zonja Bovari (Argeta)	1,090	5	5,450
Dostojekski - Vëllezërit Karamazovë, Vëll. 1	1,400	5	7,000
Dostojekski - Vëllezërit Karamazovë, Vëll. 2	1,600	5	8,000
Balzak - Xha Gorio (Uegen)	1,200	5	6,000
Sharl Bodler - Lulet e së keqes (Albas)	900	5	4,500
Kamy - I huaji (Fan Noli)	1,000	5	5,000
Kafka - Procesi (Argeta)	890	5	4,450
Lasgush Poradeci - Vallja e yjeve, Ylli i zemrës	1,200	5	6,000
Migjeni - Novelat e qytetit të Veriut, Vargjet e lira Zëvendësim - Migjeni Vargje të lira / Free Verse	900	5	4,500
Gjergj Fishta - Lahuta e Malcis (Albas)	400	5	2,000
Kadare - Pallati i Ëndrrave (Onufri)	1,000	5	5,000
Agolli - Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo	1,400	5	7,000
		Total	133,400
		Ulje 15%	**20,010**
		TOTAL ME ULJE	**113,390**